



Prishtinë: 18.07.2012

Kodi i ZRRE-së: V_425_2012

Nr. i Referencës:ZRRE/DMK_V_766_04_2012

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke marrë parasysh:

1. Kompetencat e Zyrës së Rregullatorit për Energji të dhëna në nenin 14 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë;
2. Dispozitat sipas Kreu IV, nenit 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
3. Dëshmitë e paraqitura nga palët;
4. Vendimin e DMK të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_766_04_2012**; dhe
5. Ankesën e konsumatorit me datë 26.04.2012;

Në mbledhjen e mbajtur më 18 korrik 2012, nxorri këtë:

VENDIM

- I **REFUZOHET** ankesa e konsumatorit Kadri Berisha (shifra në KEK: DPR – 123207) nga fshati Hajvali, ndaj vendimit të DMK-së, si në arsyet e paraqitura në arsyetimin e këtij vendimi.
- II **MBETET në fuqi** vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve nr. ZRRE/DMK_V_766_04_2012 i datës 13.04.2012.

Arsyetim

Me kërkesë të konsumatorit me datë 11.11.2008 punëtorët e autorizuar të KEK-ut për inspektimin e pikave matëse kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit, ku kanë evidentuar se konsumatori dyshon se njehsori elektrik regjistron energji më shumë dhe se njehsori i konsumatorit duhet të dërgohet në qendrën e kalibrimit.

Punëtorët e autorizuar të KEK-ut për ndërrim njehsori me datë 27.11.2008 kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit, ku kanë larguar nga matja njehsorin elektrik nr.11736258 dhe kanë vendosur për matje njehsorin e vet elektrik nr. 7396246.

Pas dërgimit të njehsorit elektrik në qendrën e kalibrimit punëtorët e autorizuar të qendrës së kalibrimit kanë bërë kontrollimin detal të njehsorit elektrik nr. 11736258, ku kanë konstatuar se një vulë shtetërore e ka të këputur kurse tjetrën në rregull, nga ana e jashtme dëmtime tjera nuk ka si dhe në brendi të njehsorit komisioni nuk ka vërejt ndonjë parregullsi. Pas kontrollimit detal të njehsorit elektrik punëtorët e autorizuar të KEK-ut për shqyrtim njehsori kanë shqyrtuar njehsorin elektrik nr. 11736258, ku gjatë shqyrtimit kanë konstatuar se njehsori elektrik është brenda kufijve të lejuar matës por që në tension më të vogël se 160V releu tarifor shkaktonte dridhje.

Pas kësaj konsumatori ka parashtruar ankesë në Departamentin për Konsumator në KEK duke kundërshtuar faturimin e energjisë elektrike deri në periudhën 03/2009. Departamenti për Konsumator në KEK pas ankesës së bërë nga konsumatori ka shqyrtuar lëndën e konsumatorit dhe ka theksuar konsumatorit se ka bërë korrigjimin e faturave nga periudha 01/2008 – 12/2008 sipas protokollit mbi shqyrtimin e njehsorit elektrik nr. 0035445 të datës 09.03.2009. Konsumatori pas marrjes së përgjigjes nga ana e KEK-ut, brenda afatit ligjor ka parashtruar ankesë në Departamentin



për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE me të cilin ka kundërshtuar ngarkesën për shfrytëzim të paautorizuar të energjisë elektrike.

Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve ka bërë shqyrtimin e ankesës së konsumatorit dhe me datë 01.06.2012 ka nxjerr vendim duke **refuzuar** ankesën e konsumatorit si të pabazë.

Pas marrjes së vendimit të DMK-së më datë 26.04.2012 konsumatori ka parashtruar ankesë në Bordin e ZRRE-së, me të cilën ka kundërshtuar në tërësi vendimin e DMK-së nr. ZRRE/DMK_V_766_04_12 të datës 13.04.2012.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 18.07.2012 ka shqyrtuar dhe analizuar dëshmitë e paraqitura nga konsumatori, përkatësisht kundërshtimet e theksuara në ankesë ndaj vendimit të DMK-së.

Bordi i ZRRE-s pas shqyrtimit të procesverbaleve të KEK-ut ka vërejtur se punëtorët e autorizuar të KEK-ut pas kërkesës së konsumatorit për dyshim të energjisë elektrike kanë bërë ndërrimin e njehsorit elektrik dhe duke e dërguar njehsorin elektrik nr. 11736258 në qendrën e kalibrimit për kontrollim dhe shqyrtim.

Punëtorët e autorizuar për kontrollimin e njehsorëve elektrik në laboratorin e qendrës së kalibrimit kanë konstatuar se njehsori elektrik nr. 11736258 një vulë shtetërore e ka të këputur kurse tjetrën në rregull, nga ana e jashtme dëmtime tjera nuk ka si dhe në brendi të njehsorit komisioni nuk ka vërejt ndonjë parregullsi. Pas këtij kontrollimi punëtorët e autorizuar të KEK-ut kanë bërë edhe shqyrtimin e njehsorit elektrik dhe kanë konstatuar se njehsori elektrik është brenda kufijve të lejuar matës por që në tension më të vogël se 160V releu tarifor shkakton dridhje.

Bordi ka analizuar shpenzimin e energjisë elektrike të konsumatorit dhe konstaton se konsumatori nuk ka ndryshim të shpenzimit të energjisë elektrike me njehsor të vjetër elektrik si dhe me njehsorin e ri elektrik por që konstatohet se konsumatori për periudha të ndryshme kohore ka grumbullim të energjisë elektrike si rrjedhojë e mos leximit të rregullt mujor. Mesatarja e shpenzimeve me njehsorin e vjetër nr. 11736258 prej periudhës 08/2002 e deri më 12/2008 ka qenë 935kWh/muaj; ndërsa mesatarja e shpenzimeve me njehsorin e vjetër nr. 7396246 prej periudhës 01/2009 e deri më 12/2011 është 1001kWh/muaj.

Bordi i ZRRE-së ka analizuar korigjimin e bërë përmes urdhër lejimit nr. 30373 të cilin KEK sha ka bërë faturave për periudhën 01/2008 deri 12/2008 bazuar në procesverbalin nr. 003445 të datës 09.03.2009 për vlerën 1.92% dhe konstaton se KEK sha ka vepruar drejt si dhe ka respektuar procedurat në fuqi. Sipas nenit 5.11.1 të Kodit të Matjes, theksohet se: *“Pas testimit të pajisjeve matëse dhe pasi që vërtetohet kufiri i pasaktësisë përpilohet raporti për gjendjen dhe vlerat e testuara të njehsorit. Pavarësisht a është gabimi në plus ose minus dhe tejkalon vlerën 1.5 herë e klasës së saktësisë (p.sh. për njehsorët e drejtpërdrejtë klasa e saktësisë është 2.0 %, kufiri i lejuar do të ishte 3.0%) atëherë bëhet ri-llogaritja e energjisë dhe përmirësimi i faturimit për 12 (dymbëdhjetë) muajt e fundit. Kur vendoset njehsori kontrollues dhe kur vërtetohet se dallimi në lexim është 1.5 herë më i lartë atëherë veprohet siç e thamë më lartë”*.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 18.07.2012 ka analizuar ankesën e konsumatorit dhe vendimin e nxjerr nga DMK nr. **ZRRE/DMK_V_766_04_2012**, dhe pas analizimit të hollësishëm të të gjitha dëshmimeve tjera të prezantuara në shkresat e lëndës ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.



Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së

Enver Halimi, kryesues

Përparim Kabashi, anëtar

Blerim Koci, anëtar

Merita Kostari, anëtare

Krenar Bujupi, anëtar